

ANALIZË E PROJEKTLIGJIT TË INSPEKTORATIT TË PUNËS

Autor: Qendra për Politika dhe Avokim
Data: Nëntor, 2020

Publikuar nga:

Qendra për Politika dhe Avokim
www.qpa-rks.org
info@qpa-rks.org
+383 (0) 38 226 530

Të drejtat e autorit © 2020. Qendra për Politika dhe Avokim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



Ky botim është realizuar me përkrahjen e platformës “Kosova që duam” dhe i financuar nga Friedrich Ebert Stiftung – zyra në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorëve që janë përgjegjës për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të platformës “Kosova që duam” dhe FES-it.

This publication has been produced with the support of the “Kosovo We Want” platform and funded by Friedrich Ebert Stiftung – office in Pristina. The content of this report reflects the views and opinions of the authors responsible for the factual accuracy of the data presented here. The views and opinions expressed herein do not necessarily represent those of the “Kosovo We Want” platform and of the FES.

ANALIZË E LIGJIT PËR INSPEKTORATIN E PUNËS NË KOSOVË

Tabela e përmbatjes

Tabela e përmbatjes	1
Hyrje.....	2
Gjendja e tanishme.....	3
Analizë e ligjit të tanishëm	3
Mungesa e përfshirjes së gjërave kyçe.....	3
Mungesa e detajizimit të proceseve.....	4
Analizë e inspektoratit në praktikë.....	4
Numri i inspektorëve.....	5
Mungesa e kompetencave dhe duplikimi i tyre.....	5
Narracioni i draft ligjit	6
Draft ligji i tanishëm në krahasim me ligjin e tanishëm	8
Analiza krahasimore	9
Sllovenia	9
Maqedonia e Veriut	11
Shqipëria	13
Kroacia.....	15
Letonia.....	16
Serbia	19
Kosova.....	21
Rekomandimet	24

Hyrje

Ligji për inspektorat të punës është hartuar në vitin 2002 dhe nuk ka pësuar ndonjë ndryshim fundamental që nga ajo kohë. Vetëm në vitin 2008 është amandamentuar, mirëpo kjo nuk ka paraqitur ndonjë ndryshim rrënjësor në ligj për arsye se është bërë më shumë për arsye procedurale. Arsyeja procedurale e amandamentimit është shpallja e pavarësisë së Kosovës, dhe rrjedhimisht kështu përvetësimi i ligjeve nga koha e administrimit të UNMIK-ut. Rrjedhimisht për 18 vite, inspektorati i punës ka funksionuar përmes një ligji që ka pasur mangësi dhe zbrazëtira të dukshme, dhe kështu në shumicën e rasteve është improvizuar qoftë përmes rregulloreve ose praktikave të pashkuara.

Përderisa përgjatë gjithë kohës ka pasur diskutime për intervenime përmes legjislacionit në këto zbrazëtira dhe mangësi, vetëm në vitin 2018 është arritur që të iniciohet procedura e hartimit të ligjit të ri për inspektoratin. Që nga ajo kohë janë ndërruar tre qeveri, përkitazi tre legjislatura, dhe draft ligji për inspektoratin e punës ende ka mbetur draft ligj.

Ministria e punës dhe mirëqenies sociale (MPMS) në vitin 2018 sponsorizoi draft ligjin për inspektoratin e punës. Ky ligj është draftuar përmes një grupi punues ku kanë qenë të përfshirë ndër të tjera edhe shoqëria civile. Në konsultimet publike ka pasur komente nga organizata si OSBE, institucione bankare, dhe po ashtu nga zyra e kryeministrit, mirëpo pothuajse të gjitha janë refuzuar, dhe arsyet e refuzimit janë me bazë¹. Kështu, draft ligji fillestar nga MPMS është proceduar tek komisioni për shëndetësi dhe mirëqenie sociale (KSHMS). Komisioni pas diskutimit të brendshëm ka ardhur edhe me komente, po ashtu edhe ndërhyrje në draft ligj. Ky version i draft ligjit është paraparë në agjendën legjislative të qeverisë, dhe po ashtu edhe në agjendën e kuvendit, mirëpo nuk ka arritur që të procedohet në këtë të fundit. Më 19 Korrik, 2019 jep dorëheqje kryeministri Ramush Haradinaj, dhe pastaj shpërbëhet kuvendi që e dërgoj vendin në zgjedhje të reja. Më 6 tetor, 2019 mbahen zgjedhjet e reja dhe pas 5 (pesë) muajve, më 3 shkurt 2020 votohet qeveria e re me kryeministër Albin Kurti-n, dhe kështu ligji për inspektoratin e punës kthehet në pikën zero, mirëpo prapë vendoset në agjendë legjislative. Më 25 mars, 2020 përmes mocionit të mosbesimit bie qeveria e re, dhe me 3 qershor, 2020 votohet një qeveri e re me kryeministër Avdullah Hotin dhe prapë draft ligji për inspektoratin e punës kthehet në pikën zero, dhe prapë vendoset në agjendë legjislative. Vlen të cekët që ministri i ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale, Skënder Reçica, që ka sponsorizuar ligjin e inspektoratit të punës në vitin 2018 tani është po ashtu ministër i MPMS.

Ky dokument synon të analizojë të gjitha draftet e ligjeve, dhe po ashtu ligjin aktual, kështu rrjedhimisht duke treguar rrjedhën e ndryshimeve, të tregojë mangësitë në draft ligjin e propozuar, dhe të ofrojë rekomandime duke u bazuar edhe në praktikën në vendet tjera duke

¹ Qeveria – Zyra e Kryeministrit. (2018). PROJEKT LIGJI (MPMS) NR. XX/2018 PËR INSPEKTORATIN E PUNËS. Marrë nga: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/40331-FinalAI.docx>

përfshi vendet e rajonit (Shqipëria, Serbia, dhe Maqedonia e Veriut), por edhe vende të cilat janë shembuj në mënyrën e funksionimit të inspektoratit (Sllovenia, dhe Letonia).

Gjendja e tanishme

Analizë e ligjit të tanishëm

Ligji aktual për inspektoratin e punës është draftuar në vitin 2002, dhe amendamentuar në vitin 2008. Amendamenti i vitit 2008 nuk ka qenë substancial por më shumë procedural, dhe rrjedhimisht mund të aludojmë që inspektorati i punës ka funksionuar që 18 vite pa ndryshime ligjore, ndonëse konteksti ka ndryshuar dukshëm dhe ligji i atëhershëm nuk është adekuat për zgjidhjen e sfidave që inspektorati i punës ballafaqohet. Në këtë pjesë të dokumentit do të paraqiten disa nga sfidat kryesore që ky ligj ka paraqitur për zbatimin efektiv të inspektimeve dhe rregullimin e brendshëm të inspektoratit të punës.

Mungesa e përfshirjes së gjërave kyçe

Ligji aktual, që në anën kuantitative ka vetëm 5 faqe, nuk ka arritur të përfshijë disa nga gjërat kyçe. Në këtë ligj mungon pjesa e definicioneve për llojet e inspektimeve, mungesa e detajizimit të kompetencave për Kryeinspektorin, nuk bëhet detajizimi i kompetencave të zëvendës kryeinspektorëve, nuk ceken kriteret profesionale për inspektorë të punës, nuk paracaktohen kushtet për pranimin dhe vlerësimin e inspektorëve, dhe po ashtu ka boshllëk në pjesën e ankimimit.

Llojet e inspektimeve

Llojet e inspektimeve nuk janë të paraqitura në ligj, por janë vendosur vetëm si praktikë e pashkruar nga vetë inspektorati i punës. Mungesa e llojeve të inspektimeve paraqet një problematikë pasi që nuk definohet se cilat lloje të inspektimeve ekzistojnë, dhe në çfarë rrethanash mund të bëhet një lloj i inspektimit.

Si shembull, ri-inspektimet janë inspektime që bëhen me qëllim të konstatimit të evitimit të parregullsisve të konstatuara nga inspektimi paraprak. Në mungesë të një definicioni të tillë, inspektorët mund të bëjnë inspektime të ndryshme dhe pastaj të i kategorizojnë në bazë të nevojave të tyre në raportim. Kjo paraqet problem shumë të madh sidomos në pjesën e inspektimeve të jashtëzakonshme.

Kompetencat për kryeinspektorin

Në ligjin e tanishëm kompetencat për Kryeinspektorin janë përmbledhur brenda një paragrafi, ku ceket që Kryeinspektori “është përgjegjës për zbatimin e detyrave që përmban funksioni i tij”. Askund nuk paraqitet se çfarë është funksionin apo detyrat e Kryeinspektorit dhe kështu kompetencat dhe mënyra e punës varën nga individi si Kryeinspektor dhe jo nga natyra e punës.

Si shembull, Kryeinspektori në raste të caktuara ka performuar punë menaxheriale, në raste tjera ka qenë në rolin e inspektorit, në procesin e ankimimit, dhe në raste tjera ka bërë punë financiare.

Mungesa e rolit të Kryeinspektorit dhe kompetencat e tij kanë bërë që inspektorati i punës mos të ketë një vizion të qartë. Këto janë adresuar në masë të madhe në draft ligjin e ri.

Kriteret profesionale për inspektorë, dhe pranimi në punë

Ligji nuk ka paraparë përcaktimin e kriterëve profesionale për inspektorë. Në mungesë të këtyre kriterëve profesionale inspektorët mund të jenë nga prapavija të ndryshme e që paraqet problem sidomos me inspektimin e sektorëve që kanë masa specifike (p. sh. ndërtimtaria, ose sektorët me rrezikshmëri të lartë). Ndonëse inspektimi në shumicën e rasteve mund të ketë bazë të standardizuar dhe nuk paraqet problem prapavija profesionale e inspektorit, ka raste që mungesa e prapavijës adekuate paraqet problem sidomos tek inspektimet për siguri dhe shëndet në punë. Kjo është parë si një nga sfidat kryesore të inspektoratit, prandaj edhe ligji i ri e ka trajtuar duke specifikuar fushat në të cilat inspektorët duhet të kenë eksperiencë.

Mungesa e detajimit të proceseve

Ankimimi

Procesi i ankimimit në ligjin aktual rregullon të drejtën për ankimim, dhe afatet ligjore për ankimim. Ky ligj deri në një masë përcakton shkallët e ankimimit pasi specifikon që ankesa ndaj vendimit mund të bëhet 8 ditë nga marrja e vendimit, dhe kjo ankesë bëhet tek Inspektorati i Punës. Po ashtu specifikon që mundësohet edhe ankesa direkt, apo pasi të merret vendimi për ankimim nga inspektorati në gjykatat kompetente. Mirëpo, në asnjë pjesë nuk tregon se cili organ apo çfarë përbërje do të ketë paneli që shqyrton ankesën e bërë në inspektorat. Pjesa e ankimimit nuk trajtohet as në rregullore të Inspektoratit të Punës. Në praktikë, kryeinspektori e ka formuar një komision at-hoc që ka shqyrtuar ankesat e bëra në Inspektorat.

Roli dhe kompetencat e zëvendës kryeinspektorëve

Roli dhe kompetencat e zëvendës kryeinspektorëve nuk janë të caktuara në ligj. Në fakt, zëvendës kryeinspektorët ceken vetëm njëherë në ligj ku thuhet që ata do të asistojnë kryeinspektorin në çështje juridike, mbrojtje në punë, dhe për çështje shëndetësore. Rregullorja e inspektoratit të punës për herë të parë përmend decidivisht numrin e zëvendës kryeinspektorëve, dhe fushat që ata mbulojnë, mirëpo prapë nuk e tregon qartë rolin e tyre, duke thënë vetëm që detyrat e përgjegjësitë e tyre përcaktohen me ligjin aktual në fuqi, mirëpo ky i fundit asnjëherë nuk i ka përcaktuar.

Zëvendës kryeinspektorët janë pjesë e zyrës së kryeinspektorit. Ata janë të ndarë në tre fusha: (a) marrëdhënie në punë, (b) siguri në punë, dhe (c) shëndet në punë. Këto fusha nuk janë përditësuar asnjëherë, dhe në praktikë roli i zëvendës kryeinspektorëve më shumë ka qenë ceremonial. Duke mos pasur qartësim të rolit, detyrave, dhe kompetencave, roli i zëvendës kryeinspektorëve është minuar dhe shndërruar vetëm në zëvendësim të kryeinspektorit në rast të mungesës së tij/saj.

Analizë e inspektoratit në praktikë

Në këtë pjesë të dokumentit analizohen problemet që pamundësojnë funksionimin efektiv të inspektoratit. Disa nga problemet dhe sfidat janë të adresuara në draft ligjin e propozuar, mirëpo

disa nga problemet nuk mund të zgjidhen përmes ligjit mirëpo përmes parimeve të qeverisjes së mirë.

Numri i inspektorëve

Njëra nga sfidat që inspektorati i punës e paraqet si sfidë kryesore është numri i vogël i inspektorëve. Numri i tanishëm i inspektorëve është rreth 40, që në raport me numrin e të punësuarve i bie 1 (një) inspektor për 9,000 të punësuar. Mesatarja në vendet e BE-së është 1:4000, gjë që e paraqet nevojën që inspektorët pothuajse të dyfishohen nëse dëshirojnë të arrijnë mesataren e BE-së.

Në draft ligjin e ri, fillimisht MPMS e ka vendosur që numri i inspektorëve të jetë 1 (një) në 4,000-5,000 të punësuar, që rrjedhimisht është në linjë me mesataren në BE-së. Mirëpo, komisioni ka vendosur që kjo pjesë duhet të hiqet, dhe kështu në draft ligjin e ri ky nen nuk ekziston më.

Rritja e numrit të inspektorëve është e domosdoshme, e sidomos kjo rritje duhet të përcillet me inspektorë me prapavijë në fushat për siguri dhe shëndet në punë.

Mungesa e kompetencave dhe duplikimi i tyre

Për momentin në Kosovë janë mbi 20 inspektorate të ndryshme me rreth 800 inspektorë². Decentralizimi i tyre ka krijuar konfuzitet në rolet dhe kompetencat e tyre. Një shembull konkret në këtë aspekt është ekzistenca e Inspektoratit të Punës, dhe në të njëjtën kohë edhe Inspektoratit për Miniera dhe Minerale. Inspektorati i Punës përderisa ka brenda kompetencave monitorimin e zbatimit të legjislacionit nga fusha e marrëdhënies së punës si dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë, Inspektorati për Miniera dhe Minerale i ka të njëjtat kompetenca vetëm që bënë monitorimin tek minierat dhe mineralet.

² Instituti GAP. (2014). Inspektoratet në Kosovë; organizimi dhe funksionimi. Marrë nga: https://www.institutigap.org/documents/34615_ALB-Inspektoriatet.pdf

Narracioni i draft ligjit

Draftimi i ligjit të ri për inspektoratin e punës filloj në vitin 2017, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale bashkarisht me aktorë të ndryshëm të fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë. Pas draftimit të këtij ligji, ndonëse me mangësi që në këtë punim adresohen tek rekomandimet, ky draft kaloi nëpër një proces të diskutimit publik ku shumica e komenteve të marra nuk u pranuan për revidim të ligjit. Pas përfundimit të procesit të diskutimit publik, ligji kaloi tek Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për diskutim në komision. Komisioni komentoi draft ligjin dhe me komentet e tyre draft ligji u bë gati për votim në Kuvend. Ky draft ligji, ndonëse në agjendë legislative, nuk arriti Kuvendin e Kosovës dhe në Qershor, 2019 bie Qeveria Haradinaj dhe kështu ligji rikthehet në fazën fillestare.

Draft ligji pasi rikthehet në fazën fillestare, përgjatë Qeverisë Kurti, vendoset prapë të jetë pjesë e diskutimit publik. Kësaj rradhe Ministria merr parasysh pothuajse të gjitha komentet të vendosura në draft ligjin paraprak nga Komisioni i kaluar. Kështu draft ligji i ri është në linjë me komentet e vendosura nga Komisioni, mirëpo as ky nuk arrin të vendoset në votim pasi që përmes mocionit të mosbesimit bie Qeveria Kurti.

Në këtë pikë, kjo është e 3-ta Qeveri që po e trajton këtë draft ligj. Më poshtë në mënyrë tabelare janë vendosur ndryshimet e bëra nga Komisioni tek draft ligji i Ministrisë.

Ndryshimet në draft ligjin e MPMS-së nga komentet e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie	
Nenet e ndryshuara	Ndryshimet
Neni 7, pika 1	Shërbyes civil = nënpunës civil
Neni 8, pika 2.2	Drejtor i përgjithshëm = drejtor ekzekutiv
Neni 8, pika 5	Fshihet pjesa që përcakton që numri i inspektorëve të jetë 1 inspektor:4000-5000 të punësuar
Neni 9, pika 3.1	Hiqet pjesa administrative nga përgjegjësite e Drejtorit Ekzekutiv të IP-së
Neni 9, pikat 3.4	Vendoset që Drejtori Ekzekutiv duhet të hartojë dhe propozojë raport vjetor të performancës të IP-së.

Neni 10, pika 2.1	Tek kualifikimet përkatëse universitare hiqet ekonomia nga drejtimet e mundshme
Neni 25, pika 4	Afati maksimal për pagesë të gjobës zvogëlohet nga 90 në 30 ditë
Neni 26, pika 4	Afati maksimal për përgjigje në ankesa bëhet nga 30 në 60 ditë
Neni 27	Vendoset që përcaktimi i organit për shqyrtim të ankesave vendoset bëhet nga drejtori ekzekutiv
Neni 29	Vendoset që 40% të gjobave të shkojnë në buxhet të inspektoratit

Draft ligji i tanishëm në krahasim me ligjin e tanishëm

Pasi që draft ligji i tanishëm ka ndryshuar rrënjësisht ligjin e tanishëm këto ndryshime nuk janë bërë në formë tabelare por vetëm ndryshimet kryesore janë të paraqitura më poshtë:

1. Janë detajizuar kompetencat dhe kapacitetet për pozitat e kryeinspektorit, inspektorëve
2. Është vendosur pjesa e definicioneve që rregullon llojet e inspektimeve
3. Është shtuar pjesa e ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve për inspektorë
4. Janë shtuar kriteret profesionale për inspektorë.
5. Është krijuar kriteri i provimit profesional mirëpo mungon kjartësimi për të
6. Mundësohet ftuarja e specialistëve nga fushat e ndryshme
7. Është përcaktuar mënyra e përzgjedhjes së shkallës së dytë

Analiza krahasimore

Në këtë pjesë të punimit është analizuar rregullimi i inspektoratit të punës në vendet tjera. Vendet e zgjedhura për këtë analizë krahasimore janë: Sllovenia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kroacia, Letonia, dhe Serbia. Këto vende janë zgjedhur për arsye të karakteristikave të ngjashme me Kosovën në këtë fushë, dhe disa prej tyre për të nxjerrë shembuj të mirë që mund të përdoren.

Sllovenia

Në slloveni përgjegjëse për çështjet e punës dhe të punësimit është Ministria e Punës, Familjes dhe Çështjeve Sociale. Ndërsa, Inspektorati është organ administrative që funksionon brenda kësaj Ministrie dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit dhe ligjeve, rregulloreve të tjera, kontratave kolektive dhe akteve të përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e punës, pagat, pjesëmarrjen e punëtorëve në menaxhim, greva dhe sigurinë e punëtorëve. Inspektorati i Punës gjithashtu u siguron punëdhënësve dhe punëtorëve ndihmë në lidhje me ligjet në zbatim dhe rregulloret e tjera, kontratat kolektive dhe aktet e përgjithshme brenda juridiksionit të tij. Përveç detyrave të tyre kryesore, Akti i Marrëdhënieve të Punësimit u cakton detyra të ndërmjetësimit inspektorëve të punës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale të punës. Për punën e tij inspektorati, përgatiti raport vjetor për ministrin³.

Inspektorati ka zyrën qendrore përderisa ka edhe pesë (5) degë rajonale. Udhëhiqet nga Drejtori dhe tre (3) drejtorë të cilët janë përgjegjës për një degë inspektimi.

Drejtori udhëheq dhe përfaqëson inspektoratin, organizon dhe koordinon punën e inspektorëve dhe, brenda fushës së kompetencave të tij, mbanë përgjegjësi për ligjshmërinë, cilësinë dhe efikasitetin e punës së inspektoratit. Po ashtu është përgjegjës për hartimin e planit vjetor për zbatimin e detyrave të inspektimit dhe do të përcaktojë metodën e caktimit të çështjeve inspektorëve individuale në përputhje me rregulloret që rregullojnë operacionet administrative.

Përveç zyrës qendrore dhe zyrave regjionale ekziston edhe një mekanizëm, Këshill për Inspektime i cili është trup ndërinstytucionale dhe kryesohet nga Ministri. Ky organ koordinon zbatimin e përbashkët të detyrave të inspektimit të shërbimeve të ndryshme të inspektimit dhe koordinon dhe planifikon masa për të siguruar mbështetje informacioni për shërbimet e inspektimit.

Në lidhje me politikat dhe kriteret e rekrutimit të inspektorëve, Ligji për inspektimet në Slloveni ka përcaktuar disa kritere për statusin dhe përgatitjen profesionale. Inspektorët e Punës janë

³ Labour Inspection Structure and Organization (Slovenia). Marrë nga: https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_209368/lang--en/index.htm

shërbyes civil të cilët duhet të kenë kualifikim universitar në drejtësi, ekonomi, mjekësi, sanitari ose në teknike. Se paku 5 vjet përvojë pune pasi ta kenë kaluar provimin/testin profesional

Përveç këtyre rregullave, nga inspektorët kërkohet që të ndjekin në vazhdimësi trajnime të ndryshme për ngritje profesionale dhe performancë më të mirë në punën e tyre.

Inspektori është përgjegjës për të kryer inspektime mbi marrëdhënien e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe inspektime për sigurime sociale për punëmarrësit.

Përveç inspektimeve, inspektorët kanë mandat për shqiptim të gjobave dhe masave të tjera administrative. Vendimet e inspektoratit mund të ankimohen nga palët në shkallën e dytë. Ankesa mund të bëhet në Ministri e cila është shkalla e dytë e shqyrtimit të ankesave. Nëse palët nuk pajtohen me vendimin e shkallës së dytë, atëherë kalohet në procedurë gjyqësore, dhe për këtë vendos një gjykatë kompetente.

Fushë veprimtaria	Inspektorati është kryesisht përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës por në portfolio të punës është i ndarë në tri degë: kryen inspektime mbi marrëdhënien e punës, mbi sigurinë dhe shëndetin në punë dhe inspektime të sigurimit social për punëtorët.
Organogrami	Zyra qendrore e Inspektoratit; Pesë degët rajonale; Këshilli për inspektime si trup ndërinstitucionale
Kompetencat e kryeinspektorit/drejtorit	Drejtori udhëheq dhe përfaqëson inspektoratin, organizon dhe koordinon punën e inspektorëve dhe, brenda fushës së kompetencave të tij, mbanë përgjegjësi për ligjshmërinë, cilësinë dhe efikasitetin e punës së inspektoratit. Po ashtu është përgjegjës për hartimin e planit vjetor për zbatimin e detyrave të inspektimit dhe do të përcaktojë metodën e caktimit të çështjeve inspektorëve individualë në përputhje me rregulloret që rregullojnë operacionet administrative.
Kriteret për punësim, ndërprerje, dhe vlerësim	Inspektorët e inspektoratit të punës janë shërbyes civil dhe zgjedhën përmes rekrutimit të hapur përmes një provimi apo testi gjithëpërfshirës. Ky test përfshinë njohuri nga procedurat e inspektimit, procedurat administrative dhe kontestimore, vendimmarrja dhe aplikimi i sanksioneve. Sa i përket kushteve që duhet të plotësohen për të aplikuar për inspektorë, kandidatët duhet të kenë diplomë universitare në juridik ose ekonomi ose një fushë tjetër të përafërt dhe pesë vite përvojë pune. Po ashtu, edhe pas pranimit në punë, inspektorët janë të obliguar të i nënshtrohen një testimi çdo tri vite në mënyrë që kontratat e tyre të vazhdojnë.

Inspektimet	Inspektime mbi marrëdhënien e punës, inspektimi mbi sigurinë dhe shëndetin në punë dhe inspektime të tipit të sigurimit social për punëtorët.
Gjobat	Gjoha, masa të tjera administrative.
Procedura e ankimimit	Vendimet e inspektoratit mund të ankimohen nga palët në shkallën e dytë. Ankesa mund të bëhet në Ministri e cila është shkalla e dytë e shqyrtimit të ankesave. Nëse palët nuk pajtohen me vendimin e shkallës së dytë, atëherë kalohet në procedurë gjyqësore, dhe për këtë vendos një gjykatë kompetente.
Nr i inspektoreve për te punësuar	1:10 mijë
Buxheti	Ministria e Punës, Familjes dhe Çështjeve Sociale

Maqedonia e Veriut

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale⁴ është autoriteti kryesor për çështjet e punës dhe mbrojtjes sociale, përfshirë inspektimin e punës, përderisa Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin efektiv të legjislacionit të punës, me qëllim uljen e numrit të personave të punësuar në mënyrë të paligjshme, mbrojtjen e të drejtave ligjore të punëtorëve dhe garantimin e kushteve të punës nga siguria dhe shëndeti në punë. Inspektorati kryen tre lloje të inspektimeve: sipas planit vjetor, me vetiniciativë dhe me ankesë të palës.

Drejtori⁵ përfaqëson Inspektoratin, organizon dhe koordinon punën e tij dhe garanton cilësi dhe efikasitet, në përputhje me Ligjin. Ai emërohet nga Qeveria dhe i raporton Qeverisë dhe Ministrisë. Brenda Inspektoratit ekzistojnë tre sektorë në të njëjtin nivel, secili sektor ka udhëheqësin e tij: Sektori për Inspektimin e Marrëdhënive të Punës, Sektori për Inspektimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Sektori për Legjislacionin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Inspektorët janë nëpunës civil me përvojë pune së paku 3 vjeçare dhe me kualifikim universitar. Inspektorët e marrëdhënies së punës duhet të kenë përgatitje nga fusha e drejtësisë. Ndërsa, Inspektorët e Sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të jenë inxhinierë të diplomuar në njërin nga pesë fushat teknike: mekanikë, inxhinieri civile, arkitekturë, inxhinieri elektrike, teknologji dhe mbrojtje të punës.

⁴ The Former Yugoslav Republic of Macedonia Labour Inspection Audit https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_dialogue/---lab_admin/documents/publication/wcms_240203.pdf

⁵ Ligji për Inspektimin e Punës (Maqedonia e Veriut) http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/zakon_inspekcija_trud.pdf

Ligji për inspektimet në punë ka rregulluar dhe procedurën e ankesës, sipas këtij ligji çdo vendim i inspektorit mund të apelohej tek Ministri për Punë dhe Politikë Sociale⁶, brenda tetë ditëve nga data e marrjes së vendimit. Ekzekutimi i vendimit mund të shtyhet në rast së kontesti kalon në një gjykatë kompetente.

Fushë veprimtaria	Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin efektiv të legjislacionit të punës, me qëllim uljen e numrit të personave të punësuar në mënyrë të paligjshme, mbrojtjen e të drejtave ligjore të punëtorëve dhe garantimin e kushteve të punës nga siguria dhe shëndeti në punë.
Organogrami	Drejtori i Inspektoratit; Tre sektorë: sektori për inspektime në marrëdhënie në punë. Sektori për inspektime nga Siguria dhe shëndeti në punë dhe sektori për legjislacion nga siguria dhe shëndeti në punë. Sektori për MP ka tre departamente (Qendër, lindje dhe Perëndim) Sektori për siguri dhe shëndet në punë ka brenda tij dy departamente. Të gjitha departamentet kanë drejtohen nga një udhëheqës departamenti. Sektori për Legjislacionin e SSHP, merret me transpozimin e Direktivave të BE-së mbi sigurinë në punë, ka vetëm një zyrtar në nivelin qendror.
Kompetencat kryeinspektorit/Drejtorit	Drejtori përfaqëson Inspektoratin, organizon dhe koordinon punën e tij dhe garanton cilësi dhe efikasitet, në përputhje me Ligjin. Ai emërohet nga Qeveria dhe i raporton Qeverisë dhe Ministrin.
Kriteret për punësim, ndërprerje, dhe vlerësim	Nëpunës civil me përvojë pune së paku 3 vjeçare dhe me kualifikim universitar. Inspektorët e marrëdhënies së punës duhet të kenë përgatitje nga fusha e drejtësisë. Ndërsa, Inspektorët e Sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të jenë inxhinierë të diplomuar në njërin nga pesë fushat teknike: mekanikë, inxhinieri civile, arkitekturë, inxhinieri elektrike, teknologji dhe mbrojtje të punës.
Llojet e inspektimeve	Të planifikuara, me kërkesë të palës dhe me vetiniciativë.
Gjobat	Gjoha, masa të tjera administrativ.
Procedura e ankimimit	Vendimi i inspektorit mund të apelohej tek Ministri për Punë dhe Politikë Sociale , brenda tetë ditëve nga data e marrjes së vendimit. Ekzekutimi i vendimit mund të shtyhet në rast së kontesti kalon në një gjykatë kompetente.

⁶ Po aty

Nr i inspektoreve për te punësuar | 1:8000-8500

Buxheti | Ndahet nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Shqipëria

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është në varësi të Ministrisë së Çështjeve Sociale. Ministria është autoriteti kryesor që administron çështjet e punës dhe ato sociale.

Inspektorati Shtetëror i Punës ka përgjegjësinë e zbatimit të dispozitave ligjore dhe marrëveshjeve kolektive në lidhje me kushtet e punës të tilla si: orari i punës, pagat, siguria dhe shëndeti në punë, higjiena dhe mirëqenia, puna e fëmijëve, puna e emigrantëve dhe punëtorë të tjerë të pambrojtur, donacione të ndryshme, si dhe nga të ardhura të tjera të lejuara me ligj.

Inspektorati është institucion publik dhe buxhetor⁷ në varësi të ministrit operon në dy nivele, atë qendror (Kryeinspektori, Inspektori pran kryeinspektorit, Asistenti, zëvendës kryeinspektori që është edhe Drejtor i Inspektimit për Marrëdhëniet e Punës dhe Statistikën, Drejtori i Inspektimit për Sigurinë dhe Shëndetin, Drejtori i Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore dhe Drejtori Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse në Punë) dhe në 12 degë rajonale (Drejtorët rajonal) në të gjithë vendin dhe udhëhiqet nga Kryeinspektori I cili përfaqëson inspektoratin në marrëdhëniet me palë të treta, është përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe funksionimin; zbaton dhe administron buxhetin e inspektoratit⁸. Ndërsa Drejtorët e drejtorive rajonale përveç rolit udhëheqës, përcaktojnë objektivat e punës, raportojnë çdo muaj për treguesit e inspektimit bazuar në planin e miratuar nga kryeinspektori, hartojnë raporte vjetore për veprimtaritë rajonale, ushtojnë vlerësim për efektivitetin e punës së inspektorëve, si dhe I propozojnë kryeinspektorit marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve⁹.

Inspektorët kanë autorizime për të inspektuar punëdhënësit nga marrëdhënia e punës dhe sigurisë dhe shëndetit, nëpërmjet inspektimeve të programuara, në rast të aksidenteve në punë, më ankesë të palëve si dhe inspektimeve rastësore. Sipas procedurave të rekrutimit, çdo kandidat që synon të bëhet inspektorë të ketë diplomë universitare, preferohet nga fusha e ekonomisë, mjekësisë dhe dhe inxhinierisë.

⁷ Ligji për Insektimin e Punës (Shqipëri) http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY2/13/08/21/PeR-KRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETeROR-Te-PUNeS-DHE-0125.aspx?cookiesEnabled=false

⁸ Labour Inspection Structure and organization https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_112487/lang--en/index.htm

⁹ Po aty

Për çdo shkelje të evidentuar inspektori ka të drejtë të shqiptoj gjoba, vendime dhe vërejtje. Kundër vendimit të inspektorit të punës për gjobë, subjekti ka të drejtën e ankimit të komisioni rajonal i apelimit të gjobave brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Komisioni rajonal i apelimit të gjobave shprehet me vendim brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të ankimit. Po ashtu mund të bëhet ankesë kundër vendimit të komisionit rajonal të apelimit të gjobave, subjekti mund të bëjë ankim pranë Komisionit Qendror të Apelimit të Gjobave brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të komisionit rajonal. Komisioni Qendror i Apelimit të Gjobave shprehet me vendim brenda 20 ditëve nga data e regjistrimit të ankimit. Kur vendimi i inspektorit të punës për detyrimin e pagesës së gjobës merr formë të prerë, ai është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit¹⁰.

Fushë veprimtaria	Inspektorati shtetëror mbulon fushën e punës, zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet, mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit në punë.
Kompetencat kryeinspektorit/drejtorit	Përfaqëson inspektoratin në marrëdhëniet me palë të treta, është përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe funksionimin; zbaton dhe administron buxhetin e inspektoratit
Kriteret për punësim, ndërprerje, dhe vlerësim	Një inspektor duhet të ketë diplomë universitare, preferohet nga fusha e ekonomisë, mjekësisë dhe dhe inxhinieri
Inspektimet	Inspektime të programuara; Për shkak të aksidentit në punë; Për shkak të ankesës Rastësore
Gjobat	Gjoba, masa të tjera administrativ, vendime, pezullim të punimeve
Procedura e ankimit	Komisioni rajonal i apelit Komisioni qendror i apelit
Nr i inspektoreve për te punësuar	1:11 mijë
Buxheti	Nga Ministria e Çështjeve Sociale

¹⁰ Ligji për Inspektimin e Punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës së Shqipërisë <https://www.infocip.org/al/?p=6025>

Kroacia

Inspektorati i Punës funksionon si një organizatë administrative dhe buxhetore brenda Ministrisë së Punës dhe Sistemit Pensional¹¹, e cila është edhe përgjegjëse për financim të tij. Funksionet, përgjegjësitë dhe organizimi janë të definuara me Ligjin për Inspektoratin Shtetëror. Inspektorati i Punës kryen inspektime në fushën e punës dhe shëndetit dhe sigurisë në punë, përveç nëse parashikohet ndryshe nga një ligj i veçantë.

Inspektorati është i organizuar në zyrë qendrore, zyrat regjionale dhe degët e zyrave regjionale¹². Udhëhiqet nga Drejtori i cili mban postin e ndihmës ministrit dhe është zyrtar shtetëror. Emërohet për një mandat pesë vjeçar nga Qeveria e Republikës së Kroacisë me propozim të Ministrit, me një procedurë të shpalljes publike dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të zyrës qendrore. Përveç Drejtorit ekzistojnë edhe strukturat tjera menaxhuese dhe zbatuese si: përgjegjësit e sektorëve, përgjegjësit e zyrave rajonale, shefat e departamenteve, shefat e sektorëve, shefat e zyrave të degëve të zyrave rajonale, inspektorët senior të punës - specialistët dhe inspektorët e punës¹³.

Inspektorët e zyrës qendrore kanë autorizime për të inspektuar në të gjithë territorin e Kroacisë, ndërsa zyrat regjionale të cilat janë pesë (5) dhe degët e tyre kanë mandat inspektimi në regjionin përkatës.

Sipas Ligjit të Inspektoratit¹⁴, Inspektorët janë shërbyes civil dhe rekrutohen në bazë të një konkursi të hapur dhe duhet të kenë diplomë universitare. Inspektori që inspekton marrëdhënien e punës duhet të jetë i diplomuar në drejtësi, së paku përvojë punë një vjeçare dhe testin profesional për inspektor. Ndërsa Inspektorët përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të kenë kualifikim universitar nga fushat e shkencave teknike:inxhinier i mekanikës, elektro, kimisë dhe përvojë pune katër vjeçare.

Llojet e inspektimeve edhe të ankimi janë të përcaktuar në ligj. Inspektorët kanë autorizime që të kryejnë inspektime sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesë të palës. Në rast të konstatimit të ndonjë shkelje të dispozitave të legjislacionit ata mund të marrin vendime e si: gjoba ose vërejtje. Në rast se vendimi i inspektoratit ankimohet kjo zgjidhet nga Komisioni i Ankesave i Inspektoratit të Punës. Ky organ përbëhet nga tre anëtarë dhe tre zëvendës të cilët emërohen nga Ministri me propozim të drejtorit të inspektoratit të punës.¹⁵

¹¹ Ligji për Inspektoratin e Punës së Kroacisë <http://www.mvep.hr/files/file/dokumenti/prevodenje/zakoni/zakon-o-inspektoratu-rada-nn-19-14-eng.pdf>

¹² Po aty

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

¹⁵ Po aty

Fushë veprimtaria	Inspektorati i Punës kryen inspektime në fushën e punës dhe shëndetit dhe sigurisë në punë, përveç nëse parashikohet ndryshe nga një ligj i veçantë.
Organogrami	Zyra qendror; 5 Zyra regjionale dhe degët e zyrave regjionale.
Kompetencat kryeinspektorit/drejtorit	Drejtori menaxhon aktivitetet e zyrës qendrore
Kriteret për punësim, ndërprerje, dhe vlerësim	Inspektori që inspekton marrëdhënien e punës duhet të ketë diplome universitare në drejtësi, së paku përvojë punë një vjeçare dhe testin profesional për inspektor Inspektorët përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të kenë kualifikim universitar nga fushat e shkencave teknike:inxhinier i mekanikës, elektro, kimisë dhe përvojë pune katër vjeçare
Inspektimet	Sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesë të palës
Gjobat	Inspektorët e Punës kanë mandat të shqiptimit të gjobave dhe masave të tjera administrative
Procedura e ankimimit	Shkalla e dytë zgjidhet brenda inspektoratit të punës. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre anëtarë dhe tre zëvendës të cilët emërohen nga Ministri me propozim të drejtorit nga radhët e nëpunësve civilë. Kryetari dhe nënkryetari i Komisionit të Ankesave mund të jenë një nëpunës civil i cili ka përfunduar një studim universitar ose të një universiteti ose një studim universitar dhe pasuniversitar ose një studim i diplomuar profesional në drejtësi, i cili ka të paktën katër vjet përvojë pune si inspektor i punës dhe i cili ka kaluar provimi profesional shtetëror për inspektor të punës.
Nr i inspektoreve për te punësuar	4500-5000 i përcaktuar me ligj, mirëpo në praktikë është 1:7 mijë.
Buxheti	Ministrisë së Punës dhe Sistemit Pensional

Letonia

Ministria e Mirëqenies¹⁶ është institucioni kryesor i administratës shtetërore në fushat e punës, sigurimeve shoqërore, të drejtave të fëmijëve dhe familjes si dhe barazisë gjinore dhe të drejtave të barabarta për personat me aftësi të kufizuara. Organizimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e Inspektoratit janë të rregulluara me Ligjin Shtetëror të Inspektoratit. Sipas ligjit, Inspektorati i Punës¹⁷ është autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit të punës duke përfshirë kushtet e përgjithshme të punës dhe sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili është në varësi të Ministrisë së Mirëqenies. Inspektorati ka zyrën qendrore dhe pesë (5) zyre regjionale. Zyrtarët e Inspektoratit të Punës janë Drejtori i Inspektoratit të Punës, Zëvendës Drejtori i Inspektoratit të Punës, inspektorë në të gjitha nivelet dhe nëpunës të tjerë shtetërorë shtetërorë të Inspektoratit të Punës që zbatojnë funksionin e mbikëqyrjes dhe kontrollin dhe detyrat e specifikuar në këtë ligj. Inspektorati udhëhiqet nga Drejtori i cili kryen funksionin e menaxherit të inspektoratit dhe përfaqëson atë me palët e treta. Drejtori zgjidhet nga Kabineti me propozim të Ministrit të Mirëqenies.

Misioni i Inspektoratit Shtetëror të Punës¹⁸ është të arrijë respektimin e legjislacionit për marrëdhëniet ligjore të punës dhe sigurinë dhe shëndetin në punë në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet një mjedis i sigurt, i shëndetshëm i punës dhe marrëdhënie të duhura ligjore të punës, duke ulur kështu numrin e pacientëve në punë dhe viktimat e aksidenteve në punë. Inspektorati ka mandate të bëjë inspektime të planifikuara, ri inspektime dhe inspektime tematike.

Përveç inspektimeve Inspektorët kanë autorizime që të shqiptoj gjoba dhe vërejtje. Vendimi administrativ nga Inspektorati i Punës mund të shkojë në ankimin tek drejtorja e Inspektoratit të Punës. Vendimi nga drejtorja e Inspektoratit për ankesën mund të shkojë në ankimim në gjykatë. Ankimimi nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit përveç në rastet kur personi që ekzaminon rastin lëshon një vendim eksplicit për ndalje të ekzekutimit të vendimit

Inspektorati i Punës financohet nga buxheti i Shtetit. Gjodat administrative monetare të vendosura nga Inspektorati i Punës do të përfshihen në të ardhurat e buxhetit bazë të shteti.

¹⁶ Labour Inspection Structure and Organization
[https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_209359/lang--en/index.htm#:~:text=Background%20required,receive%20200%20hours%20in%20training.](https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_209359/lang-en/index.htm#:~:text=Background%20required,receive%20200%20hours%20in%20training.)

¹⁷ Ligji për Inspektoratin Shtetëror të Punës (Letoni)
http://www.vdi.gov.lv/files/state_labour_inspectorate_law.pdf

¹⁸ Po aty

Fushë veprimtaria	Misioni i Inspektoratit të punës është të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe rregullave që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë dhe në këtë funksion inspekton punëdhënësit dhe punëtorët në përmbushjen e kërkesave ligjore në këto dy fusha
Organogrami	Zyra qendrore dhe 5 dege
Kompetencat kryeinspektorit/drejtorit	Drejtori do të përmbushë funksionet e menaxherit të një institucioni të administrimit të drejtpërdrejtë specifikuar në Ligjin e Strukturës së Administratës Shtetërore dhe përfaqësojnë Inspektoratin e Punës pa autorizim specifik, si dhe të kryejë detyrat e tjera të specifikuara në rregullator miratimet. Drejtori zgjedhet nga Kabineti me rekomandim të Ministrisë së Mirëqenies Sociale
Kriteret për punësim, ndërprerje, dhe vlerësim	Inspektorët duhet të kenë diplomë në inxhinieri, shkenca natyrore, shëndet dhe siguri në punë ose juridik. 200 orë trajnim pasi të punësohen. Ekzistojnë gjithashtu orare vjetorë trajnimi për inspektorët e punës të organizuara nga Shkolla Letoneze e Administratës Publike dhe nga ndërmarrje të ndryshme të shërbimeve të trajnimit.
Inspektimet	Të planifikuara; Ri inspektime; Inspektime tematike
Gjobat	Gjoba, pezullimi i punimeve
Procedura e ankimimit	Një akt administrativ i lëshuar nga një zyrtar i Inspektoratit të Punës ose veprim aktual mund të kontestohet te Drejtori i Inspektoratit të Punës. Akti administrativ lëshuar nga Drejtori i Inspektoratit të Punës ose veprimi aktual i tij, si dhe një vendim në lidhje me veprën e kontestuar administrative ose veprimin aktual mund të apelohe në gjykatë në në përputhje me procedurat e specifikuara në ligj.
Nr i inspektoreve për të punësuar	1:7000-7500.
Buxheti	Nga thesari i shtetit

Serbia

Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Politikave Sociale¹⁹ është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e marrëdhënieve të punës dhe të drejtat e punës në të gjitha format e punës. Inspektorati i Punës, si organ i pavarur administrativ operon në kuadër të kësaj Ministrie, dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe dispozitave të tjera në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shëndetit dhe sigurisë në punë. Inspektorati udhëhiqet nga Drejtori i cili emërohet nga Qeveria me propozimin e Ministrit²⁰.

Inspektorati i Punës është i organizuar në dy nivele:

- a. Në nivel të qendrës: Departamenti për studime analitike; Departamenti për procedurat administrative të shkallës së dytë në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shëndetit dhe sigurisë në punë; Departamentet, Seksionet dhe grupi i inspektimit të punës në njësitë e rretheve administrative në Qytetin e Beogradit.
- b. Dhe niveli regjioni 12 departament, 12 seksione dhe nje grup per inspektime ne pune i vendosur ne njësitet e distrikteve administrative

Inspektorët janë nëpunës civil me kualifikim universitar në drejtësi, ekonomi, Inxhinier i ndërtimit, makinerisë, elektro teknikes; arkitekturë, kimisë ose gjeolog. Inspektorët kryejnë detyra inspektimi dhe detyra profesionale përkatëse në fushën e marrëdhënieve të punës dhe sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me: mbikëqyrjen e rregullt dhe të kontrollit; hetimi i lëndimeve të rënda dhe kolektive dhe vdekjeve në punë; përcaktimin e përmbushjes së kushteve të përshkruara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, para fillimit të aktiviteteve të punëdhënësit, si dhe detyrave të tjera të përcaktuara me ligj. Inspektimet sipas llojit²¹ mund të jenë të rregullta, të jashtëzakonshme, kontrolluese/plotësuese, me kërkesë të palës dhe nëpërmjet kampanjave. Inspektorët mund të marrin vendime si gjoha, vërejtje dhe pezullim të punimeve. Vendimet e Inspektoratit mund të ankimohen nga pala në afat prej 8 ditëve nga marrja e vendimit. Apeli nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit. Vendimi final për ankesën vjen nga ministri 15 ditë pas marrjes së ankesës. Vendimi final nuk mund të kontestohet në procedura administrative²².

¹⁹ Ligji i Punës (Serbi) <https://www.ilo.org/dyn/travail/docs/2403/Labour%20Law%20Republic%20of%20Serbia.pdf>
<https://www.minrzs.gov.rs/srb-lat/struktura/organi-uprave-u-sastavu-ministarstva/inspektorat-za-rad>

²⁰ Submission from the CENTRE FOR DIGNIFIED WORK SERBIA (CDR SRBIJA) for consideration at the 52nd pre-session of the Committee for Economic Social and Cultural Rights (28 April - 23 May 2014) https://www.ecoi.net/en/file/local/1076044/1930_1396523870_int-cescr-css-srb-16618-e.pdf

²¹ Inspektorati I Punës (Serbi) <https://www.minrzs.gov.rs/srb-lat/struktura/organi-uprave-u-sastavu-ministarstva/inspektorat-za-rad>

²² Ligji i Punës (Serbi) <https://www.ilo.org/dyn/travail/docs/2403/Labour%20Law%20Republic%20of%20Serbia.pdf>

Fushë veprimtaria	Inspektorati i Punës, si organ administrativ në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, do të kryejë mbikëqyrje mbi zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera në fushën e punës, marrëdhënies të punës dhe shëndetit dhe sigurisë në punë
Organogrami	<p>Brenda ministrisë: drejtori/asistenti i drejtorit;</p> <p>Departamenti për studime analitike; Departamenti për procedurat administrative të shkallës së dytë në fushën e marrëdhënies të punës dhe shëndetit dhe sigurisë në punë; Departamentet, Seksionet dhe grupi i inspektimit të punës</p> <p>në njësitë e rretheve në administrative në Qytetin e Beogradit.</p> <p>jashtë ministrisë:</p> <p>12 departament, 12 seksione dhe një grup për inspektime në punë i vendosur në njësitë e distrikteve administrative.</p>
Kompetencat kryeinspektorit/drejtorit	Vetëm thuhet që udhëheq inspektoratin e punës në cilësinë e menaxherit
Kriteret për punësim, ndërprerje, dhe vlerësim	Nëpunës civil me kualifikim universitar: Drejtësi, Ekonomi. Inxhinier i ndërtimit, makinerisë, elektro teknikes, arkitekturë, Inxhinier i kimisë; gjeolog.
Inspektimet	<p>Sipas detyrës zyrtare,</p> <p>Kampanjave;</p> <p>Me kërkesë të palëve</p>
Gjobat	Gjoha, dhe pezullim të punimeve
Procedura e ankimimit	Vendimet e Inspektoratit mund të ankimohen nga pala në afat prej 8 ditëve nga marrja e vendimit. Apelimi nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit. Vendimi final për ankesën vjen nga ministri 15 ditë pas marrjes së ankesës. Vendimi final nuk mund të kontestohet në procedura administrative
Nr i inspektoreve për të punësuar	1:10 mijë.
Buxheti	Ndahet nga Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Politikave Sociale

Kosova

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nder të tjera është përgjegjëse për hartimin e politikave të marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë. Inspektorati i Punës është organ i pavarur ekzekutiv²³ që operon brenda kësaj Ministrie. Projektligji ka përcaktuar rregullimin e statusit, mandatit, organizimit, procedurave të inspektimit, si dhe detyrave dhe përgjegjësive të Inspektoratit të Punës²⁴. Inspektorati i Punës është i autorizuar që të kryej inspektime nga fusha e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë dhe fusha të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta. Inspektimet janë të disa llojeve: inspektim i rregullt; i jashtëzakonshëm; sipas parashtresave të palëve; Inspektime në bashkëpunim me institucione të tjera dhe Ri-inspektim.

Sipas Projektligjit, Inspektorati i Punës operon në nivel qendror dhe ushtron funksionet e tij në tërë territorin e Kosovës. Pjesë përbërëse të strukturës organizative janë: Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, Zëvendësit e Drejtorit Ekzekutiv, Departamentet dhe Divizionet, Zyra e Menaxherëve Regjional dhe Inspektorët e Punës .

Drejtori Ekzekutiv udhëheq Inspektoratin e Punës, është përgjegjës për ushtrimin e funksionit të tij dhe i raporton drejtpërdrejt Ministrit. Drejtori Ekzekutiv ka statusin e nëpunësit civil i kategorisë së lartë drejtuese dhe zgjedhja e tij/saj bëhet në pajtim me Ligjin për Zyrtarët Publik.

Në lidhje me kriteret e kualifikimit për inspektorët, projektligji ka përcaktuar së një inspektor duhet të posedojë diplomë universitare në drejtësi, inxhinieri ndërtimore, inxhinieri mekanike, elektrike, inxhinieri kimike, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe fusha të tjera të ngjashme, si dhe së paku tre (3) vjet përvojë punë përkatëse profesionale; si dhe të ketë kryer provimin profesional shtetëror për inspektor të punës.

Në rast së pala konsideron së gjatë inspektimi një vendim i nxjerrë nga inspektori i punës ka shkaktuar shkelje të të drejtave ligjore, ka të drejtën e parashtrimit të ankesës pranë Inspektoratit të Punës si organ i shkallës së dytë i vendimmarrjes, në përbërje prej së paku tre (3) anëtarë. Organizimi dhe përbërja e organit të shkallës së dytë përcaktohet nga Drejtori ekzekutiv i Inspektoratit të Punës

Parashtrimi i ankesës, duhet të bëhet brenda tetë (8) ditëve dhe i njëjti shtyn ekzekutimin e vendimit të shkallës së parë në pajtim me legjislacionin ne fuqi, përveç kur rrezikohet drejtpërdrejtë jeta dhe shëndeti i të punësuarave dhe palëve të tjera.

²³ Projektligji për Inspektoratin e Punës

²⁴ Po aty

Fushë veprimtaria	Inspektorati i Punës bënë mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së legjislacionit ndaj personave fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj, privat dhe publik që ushtrojnë veprimtari fitimprurëse apo jo fitimprurëse në territorin e Republikës së Kosovës. Inspektorati i Punës veprimtarinë e vetë inspektive e ushtron në fushën e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.
Organogrami	<p>Inspektorati i Punës është i organizuar në nivel qendror dhe funksionet e tij i ushtron në tërë territorin e Republikës së Kosovës..</p> <p>Struktura organizative:</p> <p>Zyra e Drejtorit ekzekutiv; Zëvendësit e Drejtorit ekzekutiv;</p> <p>Departamentet dhe Divizionet;</p> <p>Zyra e Menaxherëve Regjional; dhe Inspektorët e Punës.</p>
Kompetencat kryeinspektorit/Drejtorit	Drejtori Ekzekutiv udhëheq Inspektoratin e Punës dhe është përgjegjës për ushtrimin e funksionit të Inspektoratit të Punës.
Kriteret për punësim, ndërprerje, dhe vlerësim	Diplomë universitare në drejtësi, inxhinieri mekanike, inxhinieri ndërtimore, inxhinieri elektrike, inxhinieri kimike, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe fusha të tjera të ngjashme; së paku tri (3) vjet përvojë pune përkatëse profesionale; si dhe të ketë kryer provimin profesional shtetëror për inspektor të punës.
Inspektimet	Inspektim të rregullt; Inspektim të jashtëzakonshëm; Inspektim sipas parashtresave të palëve; Inspektime në bashkëpunim me institucione të tjera dhe ri-inspektim.
Procedura e ankimimit	<p>Në rast se pala parashtron ankesën ndaj vendimit të lëshuar nga Inspektori i Punës, procedura zhvillohet pranë Inspektoratit të Punës si organ i shkallës së dytë i vendimmarrjes, në përbërje prej së paku tre (3) anëtarë.</p> <p>Parashtrimi i ankesës, duhet të bëhet brenda tetë (8) ditëve dhe i njëjti shtyn ekzekutimin e vendimit të shkallës së parë në pajtim me legjislacionin në fuqi, përveç kur rrezikohet drejtpërdrejtë jeta dhe shëndeti i të punësuarave dhe palëve të tjera.</p>

Nr i inspektoreve për të punësuar

Organizimi dhe përbërja e organit të shkallës së dytë përcaktohet nga Drejtori ekzekutiv i Inspektoratit të Punës

1:7000-8000.

Buxheti

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Rekomandimet

- ❖ Zëvendës Drejtorët duhet të kenë kompetenca të qartësuar, dhe punë të definuar. Kjo duhet të rregullohet me rregullore të punës të inspektoratit që veçanërisht vendos zv. Drejtorët në pozitën e koordinimit/menaxhimit të drejtorëve rajonal në fushat e tyre respektive
- ❖ Pjesa e testimit të inspektorëve duhet të përfshijë të gjithë inspektorët e tanishëm, dhe po ashtu edhe çdo inspektor të ri. Testimi duhet të rregullohet në kuadër të Institutit të Administratës Publike, dhe pyetjet dhe komisioni duhen të përbëhen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administratës Publike, dhe ekspertë të jashtëm.
- ❖ Ankimimi në ligjin e ri duhet të rregullohet në linjë me ligjin e procedurës së përgjithshme administrative.
- ❖ Të rregullohet ose përmes ndonjë akti tjetër, ose si pjesë e draft ligjit, aspekti gjinor në inspektorat të punës. Kjo parasheh rritje deri në 50% të inspektoreve gra duke përfshirë edhe ndarje të barabartë në pozita.
- ❖ Inspektimet duhet të ndahet në dy fushëveprime: siguria dhe shëndeti në punë dhe marrëdhënie në punë. Inspektorët duhet të ndahen bazuar në fushëveprimet e përmendura.
- ❖ Zyret rajonale duhet të kenë kompetenca më të avancuara që e mundësojnë përpilimin e planit të punës, dhe politikave, në bazë të nevojave të regjionit. Kjo mundëson që sektorët e veçantë në regjione të caktuara të kenë qasje adekuate që përshtatet me nevojat.
- ❖ Gjobat të jenë të ekzekuteshme dhe të mos ndalen gjatë ose pas ankimimit deri në vendim të shkallës të fundit.
- ❖ Numri i inspektorëve të përcaktohet në bazë të numrit të punësuarve.
- ❖ Duhet miratuar një ligj i veçantë që rregullon inspektimet në nivel nacional, i cili do të ndihmonte në koordinimin e të gjitha inspektorateve që operojnë në Kosovë